

**R E L A C I O N**

**PËR**

**PROJEKTLIGJIN**

**PËR PRODHIMIN BIOLOGJIK, ETIKETIMIN E PRODUKTEVE**

**BIOLOGJIKE DHE KONTROLLIN E TYRE**

**I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Qëllimi i këtij projektligji është të përcaktojë parimet dhe rregullat për prodhimin biologjik, lidhur me certifikimin dhe përdorimin e treguesve që i referohen prodhimit biologjik në etiketim dhe reklama, dhe rregullat për kontrollin zyrtar, që të sigurojë bazën për zhvillimin e qëndrueshëm të prodhimit organik, funksionimin efikas të tregut të brendshëm dhe garantimin e konkurrencës së drejtë, besimin dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve.

Projektligji synon të arrihen disa objektiva:

- të kontribuojë për mbrojtjen e mjedisit dhe klimës;
- të ruajë pjellorinë afatgjatë të tokës dhe të kontribuojë për një nivel të lartë biodiversiteti;
- të kontribuojë për standarde të larta të mirëqenies së kafshëve dhe të nxisë ruajtjen e racave të rralla dhe autoktone në rrezik zhdukje;
- të nxisë zinxhirin e shkurtër të shpërndarjes dhe prodhimit lokal në zona të ndryshme të vendit;
- prodhimin e produkteve ushqimore me cilësi të lartë.

**II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Ky projektligj do të parashikohet për tu miratuar në Programin të Përgjithshëm Analitik të Projektakteve të vitit 2024, dhe është parashikuar në Planin Kombëtar të Integritimit European 2023-2025, për tu miratuar në vitin 2024.

**III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Prodhimi organik është një sistem i menaxhimit të fermës dhe të prodhimit të ushqimit, që kombinon praktikatat më të mira mjedisore, një nivel të lartë të larmisë

organike, ruajtjen e burimeve natyrore, zbatimin e standardeve të larta për mirëqenien e kafshëve dhe një metodë prodhimi në pajtim me kërkesat e disa konsumatorëve mbi produktet që prodhohen duke përdorur substancat dhe proceset natyrore.

**Bujqësia organike** është pjesë e Strategjisë së BE-së “Nga ferma në tavolinë” dhe konsiderohet si një sistem i rëndësishëm e i qëndrueshëm bujqësor, me një objektiv që të paktën 25% e tokës bujqësore të BE-së të jetë nën bujqësi organike deri në vitin 2030. Shqipëria ka rreth 1000 ha tokë **bujqësi organike**, e cila është me pak se 1 % e sipërfaqes bujqësore. Duke qenë se potenciali për eksport është i lartë dhe tregu i BE-së për produkte organike vazhdon të rritet, ndërkohë që edhe preferenca e konsumatorit vendës shfaq, gjithashtu, një tendencë pozitive, pritet që sipërfaqja me bujqësi organike në Shqipëri të rritet.

Në përmbushje të angazhimeve të Agjendës së Gjelbër, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka përcaktuar në strategjinë ndersektoriale të bujqësisë dhe zhvillimit rural dhe peshkimit 2021-2027, disa objektiva për të mundësuar një sektor agrorshqimor dhe peshkimi të efektshëm, inovativ dhe të qëndrueshëm në Shqipëri.

Ndër të tjera SNBZHRP-ja është më ambicioze në drejtim të mjedisit për përdorimin e reduktuar dhe të efektshëm të plehrave dhe pesticideve dhe rritjen e sipërfaqeve bujqësore të përdorura në bujqësi organike.

Në kuadër të objektivit ”për nxitjen e menaxhimit të qëndrueshëm dhe të efektshëm të burimeve natyrore”, ndër të tjera përcaktohet si nevojë inkurajimi i bujqësisë organike, për të rritur sipërfaqen organike. Për arritjen e objektivit për rritjen e sipërfaqes organike, në strategji janë përcaktuar ndërhyrjet nëpërmjet:

### ***1. Masave mbështetëse kombëtare dhe nga programi IPARD III, për fermat organike.***

- Vitet e fundit është aplikuar skema kombëtare mbështetëse për fermat në kalim në bujqësi organike në vitin e parë me 750 euro, vitin e dytë dhe të tretë 1200 euro dhe ferma organike 1600 euro, e cila ka ndikuar në rritjen e fermave dhe të sipërfaqes së kultivuar organike.

- Në kuadër të Programit IPARD III 2021–2027, po përgatitet akreditimi i masës M4 “agro-mjedis-klimë dhe bujqësia organike”, e cila do të mbështesë disa nënsektorë pilot:

- Perime organike – 410 Euro/ha
- Ullishte dhe vreshta organike – 843 Euro /ha
- BMA organike – 300 Euro /ha

### ***2. Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe administrative drejt përafrimit me acquis e BE-së.***

Në zbatim të këtij objekti ndërsektorial kërkohet përditësimi i legjislacionit për bujqësinë organike me atë të BE-së, i cili ka hyrë në fuqi në Janar 2022,

përkatësisht rregullorja kuadër 848/2018/KE për prodhimin organik dhe etiketimin e produkteve organike dhe shfuqizimin e Rregullores së Këshillit (KE) nr. 834/2007, dhe 50 rreguloret implementuese.

Me mbështetjen e projektit BIO.RE.GOAL “Për përmirësimin e kuadrit rregullator dhe institucional për bujqësinë organike në Shqipëri”, financuar nga CEI dhe zbatuar nga CIHAM- Bari, Itali, Grupi ndërinstitucional i punës ka hartuar projektligjin për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre, duke përafuar rregulloren 848/2018/KE për prodhimin organik dhe etiketimin e produkteve organike dhe shfuqizimin e rregullores së Këshillit (KE) nr. 834/2007 dhe rregulloren 625/2017/KE për kontrollet zyrtare dhe aktivitetet e tjera zyrtare.

Ky projektligj përditësohet me të gjitha dispozitat e rregullores 848/2018/KE, përveç atyre që janë të detyrueshme vetëm për vendet anëtare si raportimi në Komisionin Evropian për rezultatet e kontrolleve të kryera dhe për masat e marra në rast mospërputhjeje,

aksesi në Sistemin e Informacionit të Bujqësisë Organike (OFIS), rregullat e importit në BE, janë përafuar pjesërisht.

Legjislacioni ekzistues, ligji nr. 106/2016, “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, nuk sigurojnë funksionimin e duhur të sistemit të kontrollit dhe tregut të produkteve organike me qëllim sigurimin e besimit të konsumatorit për produktet e etiketuara si organike, prandaj ishte i nevojshëm përditësimi me kërkesat e legjislacionit të ri Evropian.

Projektligji, i cili përafuron rregulloren e Këshillit Evropian 848/2018 “Mbi prodhimin organik dhe etiketimin e produkteve organike”, ka adresuar dhe përmirësuar disa problematika të hasura gjatë zbatimit të ligjit ekzistues, si më poshtë:

- Lidhur me produktet dhe substancave që përdoren në prodhimin organik, përveç listës së produkteve dhe substancave për përdorim në prodhimin organik plotësisht e harmonizuar me listën e BE-së, që miratohet me urdhër ministri, do të miratohet edhe lista pozitive e PMB-ve dhe plehrave që përdoren në bujqësinë organike nga komisionet për regjistrimin e PMB-ve dhe plehrave për tu përdorur në bujqësinë jo organike, që funksionojnë në Ministri.
- Procedura për njoftimin e aktivitetit (do krijohet dhe mirëmbahet databaza e bujqësisë organike për të gjithë operatorët nën sistemin e certifikimit organik, duke përfshirë edhe importuesit dhe eksportuesit) duke mundësuar informacion të më të gjërë për operatorët organik;
- Përgjashtimet nga rregullat e prodhimit organik, do të miratohen nga Komisioni për prodhimin Biologjik, që funksionon në Ministri, ndërsa miratoheshin nga TK;

- Kriteret dhe procedura për miratimin e TK (janë shtuar dispozita dhe kërkesa për njoftimin e aktivitetit nga TK të cilat certifikojnë sipas standardeve organike të tjera nga ky ligj, me qëllim vendosjen e komunikimit dhe marrjen e informacionit nga këto trupa kontrolli);
- Përcakton sistemin e kontrollit për prodhimin organik dhe
- Kontrolli zyrtar dhe aktivitete të tjera (janë përcaktuar autoritetet përgjegjëse për kontrollin në çdo hallkë të zinxhirit të prodhimit organik dhe detyrat për çdo autoritet (Autoritetin Kompetent, Trupat e Kontrollit, Autoritetin e Kontrollit të Ushqimit) në përputhje me kërkesat e rregullores 848/2018/KE dhe nene të caktuara të rregullores 2017/625/KE;
- burimi i të dhënave për import-eksportin e produkteve organike, është dakortësuar dhe vendosur në ligj detyrimi për Autoritetet Doganore për të paraqitur këto të dhëna në bazë vjetore në Ministri),
- Unifikimi i katalogut të masave, i cili do të hartohet nga Ministria, ndërsa ishte nga TK);
- Rregullat e importit, është ngritur regjimi i importit ekuivalent me atë të BE-së, janë përcaktuar detyrat dhe detyrimet e autoriteteve të kontrollit (dogana, AKU, TK)
- Shkeljet administrative (gjoha) janë përcaktuar për herë të parë me qëllim mbrojtjen e përdorimit fiktiv/mashtrues të termave që i referohen metodës së prodhimit organik, në etiketim, reklamë.

Me miratimin e këtij ligji, pritet të ketë një funksionim më efikas të sistemit të kontrollit dhe tregut të produkteve organike, rritje të numrit të operatorëve të prodhimit organik, komunikim dhe shkëmbim të informacionit midis autoritetit kompetent dhe autoriteteve të kontrollit, duke siguruar besimin te konsumatori për produktet e etiketuara ose reklamuar si organike.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Ky projektligj hartohet në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

#### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)**

Ky projektligj përfron pjesërisht Rregulloren e Komisionit Europian 848/2018/KE për prodhimin organik dhe etiketimin e produkteve organike dhe shfuqizimin e Rregullores së Këshillit (KE) nr. 834/2007/KE.

## VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Në projektligj janë shmangur referencat dhe janë ndarë nënet sipas nevojës, duke u përshtatur me përmbajtjen e rregullores nr. 848/2018/KE.

Rregullorja 848/2018, parashikon miratimin nga KE të rregulloreve deleguese dhe implementuese sipas ceshtjeve të caktuara, (disa prej të cilave janë miratuar të tjera akoma), të cilat në projektligj janë parashikuar të miratohen me akte nënligjore.

Projektligji është ndarë në 8 (tetë) krerë.

**Në kreun e parë**, përcaktohet qëllimi i këtij projektligji, fusha e veprimit dhe përkufizimet.

- Tek fusha e zbatimit përfshihen edhe produktete të tjera të lidhura ngushtë me bujqësinë, të përcaktuara në Aneksin I, të rregullores 848/2018, të cilat parashikohen të përcaktohen me urdhër të ministrit (neni 2, pika 1, shkronja d).
- Gjithashtu, në nenin 2 pika 6, është shtuar kërkesa që produktet biologjike të prodhuara dhe përgatitura në Shqipëri dhe që synohen të vendosen në tregun shqiptar, duhet të certifikohen sipas rregullave të këtij ligji, për të shmangur problematikën e identifikuar gjatë zbatimit të ligjit ekzistues, që produktet e certifikuara për eksport sipas standarteve të tjera nga ky ligj, nëq vendosen në tregun shqiptar duhet të certifikohen sipas këtij ligji dhe të përmbajnë logon kombëtare.
- Përkufizimi lidhur me "Autoriteti i kontrollit organik" nuk ka kuptimin e dhënë në rregulloren 848/2018/KE për inspektimin dhe certifikimin e operatorëve organik, pasi në kemi në zbatimin certifikimin nga trupat e kontrollit private të miratuara/regjistruara nga Komisioni për Prodhimin Biologjik. Ky përkufizim është përdorur për AKU- në, i cili duhet të kryejë kontrollin e zbatimit të kërkesave të këtij ligji, në treg dhe importin e produkteve biologjike.

**Në kreun e dytë**, përcaktohen objektivat dhe parimet e përgjithshme dhe të veçanta për prodhimin biologjik.

**Në kreun e tretë**, përcaktohen rregullat e prodhimit, përkatësisht:

- **rregullat e përgjithshme të prodhimit**, nenet 9, 10 dhe 11, për lejimin e përdorimit në prodhimin biologjik vetëm të produkteve dhe substancave të përcaktuara në nenet 22, 23 dhe 24, ndalimin e përdorimit të OMGJ-ve dhe të rrezatimit jonizues në prodhimin organik etj.

Në pikën 5 të nenit 9, përcaktohet që në prodhimin biologjik bimor lejohet përdorimi i produkteve dhe substancave bujqësore të tjera nga ato të përcaktuara në nenin 22 të këtij ligji, me kusht që përdorimi i tyre të jetë në përputhje me parimet e përcaktuara në kreun II të këtij ligji. Këto produkte janë me origjinë bujqësore të cilat janë përdorur në praktikën bujqësore për mbrojtjen e bimëve, si p.sh uthulla, qumeshti i bletës, dylli etj, dhe lejohen të përdoren nga trupat e kontrollit që kryejnë certifikimin.

Në nenin 10, pika 5, parashikohen rregulla të hollësishme për kalimin *për specie të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 3, të nenit 14* të këtij ligji, në përputhje me parashikimin në pikën 5 të nenit 10 të rregullores 848/2018/KE, e cila parashikon që do të amendohet pjesa II, Aneksi II duke shtuar rregulla për për specie të ndryshme nga ato të trajtuara në pjesën II, aneksi II (përafrimi i pjesëve të Aneksit II është parashikuar me udhëzime të ministrit, sipas llojit të prodhimit bimor, blegtoral, akuakultura dhe i përpunuar).

- **Rregullat e hollësishme të prodhimit**, sipas llojit të prodhimit bimor, blegtoral , parashikohen në nenet 12-18, të këtij ligji, të cilat do të përafrojnë Aneksin II dhe rregullores të tjera deleguese dhe implementuese në përputhje me rregulloren 848/2018/KE.
- Rregullat e hollësishme për prodhimin dhe kalimin e produkteve që përcaktohen në shkronjës d), të pikës 1, të nenit 2 me urdhër ministri, (Aneksi I i reg.848/2018/KE), parashikohen në nenin 19.
- **Në nenin 20, parashikohen përjashtimet nga rregullat e prodhimit biologjik**, kur si pasojë e fatkeqësive natyrore ose fatkeqësive të tjera kanë ndodhur ngjarje katastrofike, që e bëjnë të pamundur përmbushjen e rregullave të prodhimit. Përjashtimet miratohen nga Komisioni për Prodhimin Biologjik (KPB) për një periudhë të kufizuar, derisa prodhimi biologjik të mund të rikthehet në kushte normale, Kriteret e përcaktimit të një situate si “ngjarje katastrofike” ose çdo situatë e krahasueshme, rregullat dhe procedurat e KPB për miratimin e përjashtimeve nga rregullat e prodhimit, si dhe rregullat për monitorimin dhe raportimin në raste të tilla, miratohen me udhëzim të ministrit, në përputhje me rregulloren
- **Produktet dhe substancat që përdoren në prodhimin biologjik (nenet 22-24) , përkatësisht:**
  - ❖ Lista e produkteve dhe substancave që përdoren në prodhimin biologjik, që miratohet me urdhër të ministrit (pika 4, neni 22) , duke përafruar plotësisht listën e BE-së, të përcaktuar në rreg. 1165/2021/KE, cila përmban:
    - ✓ lëndë vepruese në përmbajtje të produkteve për mbrojtjen e bimëve;
    - ✓ plehërues, përmirësues të tokës dhe lëndë ushqyese, në përmbajtje të produkteve plehërues;

- ✓ lëndët e para për ushqime jo biologjike për kafshë me origjinë bimore, shtazore, nga algat, ose majatë ose si lëndë e parë për ushqime për kafshë me origjinë mikrobike apo minerale;
- ✓ produkte për pastrimin dhe dezinfektimin e pellgjeve, kafazeve, depozitave, kanaleve ujore, ndërtesave ose impianteve që përdoren për prodhimin biologjik shtazor;
- ✓ produkte për pastrimin dhe dezinfektimin e ndërtesave dhe impianteve që përdoren për prodhimin bimor, përfshirë ruajtjen në një fermë bujqësore;
- ✓ produkte për pastrim dhe dezinfektim në stabilimentet e përpunimit dhe ruajtjes.

Lista pozitive e PMB-ve dhe produkteve plehëruese (që duhet të kenë në përmbajtje të tyre produktet dhe substancat e miratuara sipas pikës 4, neni 22), që përdoren në prodhimin biologjik, do të miratohen nga komisionet ekzistuese në Ministri, për regjistrimin e PMB-ve dhe produkteve plehëruese që përdoren në bujqësinë konvencionale. Pas miratimit PMB-të dhe produktet plehëruese pajisen me certifikatë miratimi për tu përdorur në bujqësinë biologjike si dhe në etiketën e produktit shtohet shënimi, “për përdorim në prodhimin biologjik”, duke orientuar fermerët për përdorimin e tyre.

- ❖ Lista e produkteve dhe substancave që përdoren në prodhimin e *ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë, të përpunuara dhe majave*, përcaktohet në pikën 3, neni 23, duke u përafëruar plotësisht me listën e BE-së të përcaktuar në rreg. 1165/2021/KE.
- ❖ Në nenin 24, parashikohet procedura për miratimin nga KPB, të përdorimit të përkoshem të përbërësve bujqësorë jo biologjikë për prodhimin e ushqimeve biologjike të përpunuara, të tjerë nga ata të përcaktuar në listën sipas në pikën 3, neni 23, në rastin kur përbërës të caktuar bujqësorë nuk gjenden në formë biologjike në sasi të mjaftueshme. Këto përbërësve bujqësorë jo biologjikë duhet të jenë të miratuar për përdorim të përkoshem nga të paktën një vend anëtar i Bashkimit Evropian (lista në ëbsite e BE-së).

**Në kreun e katërt**, përcaktohen rregullat për etiketimin e produkteve biologjike.

Rregullat për përdorimin e termave që i referohen prodhimit biologjik (termi "biologjik" ose "organik" dhe shkurtimet, si "bio" ose "eko") në etiketimin, reklamën ose dokumentet tregtare të produktit biologjik që plotëson kërkesat e këtij ligji, përcaktohen në nenin 29.

Ndalohet përdorimi në etiketim, reklama, ose në dokumentet tregtare, i termave që i referohen prodhimit organik, në një produkti i cili nuk është në përputhje me këtë ligj,

Gjithashtu, në etiketim apo reklama, nuk përdoren terma përfshirë edhe termat që përdoren në markat tregtare ose emrat e kompanive, ose praktika të tjera, që mund të keqinformojnë ose mashtrojnë konsumatorin ose përdoruesin duke sugjeruar se një produkt ose përbërësit e tij plotësojnë kërkesat e përcaktuara në këtë ligj.

Produktet e prodhuara gjatë periudhës së kalimit nuk etiketohen ose reklamohen si produkte biologjike ose në kalim (pika 4, neni 29). Në përjashtim, mund të etiketohen dhe reklamohen si produkt në kalim vetëm materiali mbjellës dhe shumëzues bimor, produktet ushqimore me origjinë bimore dhe ushqimet për kafshë me origjinë bimore, të prodhuara gjatë periudhës së kalimit, duke përdorur termin '*në kalim biologjik/organik*'.

Në nenin 34, përcaktohet logoja kombëtare e prodhimit biologjik, që duhet të përdoret në etiketimin, paraqitjen dhe reklamimin e produkteve të prodhuara në vend të cilat plotësojnë kërkesat e përcaktuara në këtë ligj dhe që vendosen në tregun shqiptar.

Logo europiane për prodhimin biologjik, mund të përdoret në etiketimin, paraqitjen dhe reklamimin e produkteve të importuara në përputhje me kërkesat e përcaktuara në kreun VIII të këtij ligji (pika 6, neni 34).

**Në kreun e pestë,** përcaktohen rregullat për certifikimin e produkteve biologjike.

Në nenet 35-37, përcaktohet kërkesa dhe procedura për regjistrim të aktivitetit në Ministri, përpara vendosjes në treg të produktit si biologjik ose në kalim, nga operatorët dhe grupi i operatorëve, *të cilët prodhojnë, përgatisin, shpërndajnë ose ruajnë produkte biologjike ose në kalim, importojnë ose eksportojnë, ose vendosin në treg produkte të tilla.*

Regjistrimi i aktivitetit do të kryhet sipas procedurave online nëpërmjet portalit e-albania.

Pasi operatori ose grupi i operatorëve ka paraqitur kërkesën për regjistrim në Ministri, duhet të lidhë kontratë me trupën e kontrollit të zgjedhur dhe të deklaruar në kërkesë dhe brenda 90 ditëve (afati maksimal i vendosur nga diskutimi me trupat e kontrollit, në varësi të prodhimit që certifikohet) nga lidhja e kontratës, trupa e kontrollit duhet të përfundojë inspektimin e operatorit të cilit i lëshon certifikatën zyrtare dhe e dërgon atë në Ministri.

Menaxhimi i procesit të regjistrimit (neni 37) duhet të kryhet nga sektori i dedikuar për prodhimin biologjik, i cili duhet të ngrihet në MBZHR, për zbatimin e kërkesave të këtij ligji, i cili pranon kërkesat dhe menaxhon procesin e regjistrimit, duke ngritur dhe përditësuar database për të gjithë operatorët dhe/ose grup operatorët, *që prodhojnë, përgatisin, shpërndajnë ose ruajnë produkte*



*biologjike ose në kalim, importojnë ose eksportojnë, ose vendosin në treg produkte të tilla.* Ministria mban listën e përditësuar me emrat dhe adresat e operatorëve ose grup operatorëve, që kanë regjistruar aktivitetin e tyre, bashkë me informacionin për certifikatat zyrtare të lëshuara dhe e publikon në faqen zyrtare. Publikimi i këtyre të dhënave kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Formati dhe mjetet teknike të regjistrimit të aktivitetit dhe masat për publikimin e listës së operatorëve dhe grup operatorëve të regjistruar, parashikohen të miratohen me udhëzim të ministrit (pika 5, neni 37).

Trupat e kontrollit pajisin me certifikatë zyrtare çdo operator ose grup operatorësh që ka paraqitur kërkesë për regjistrimin e aktivitetit të tij dhe është në përputhje me kërkesat e këtij ligji (neni 38). Certifikata zyrtare, lëshohet në format fizik ose elektronik kur është e mundur, në varësi të operatorit të certifikuar (certifikatë fizike për fermerët që nuk përdorin sistemin e digitalizuar).

Certifikimi i grupit të operatorëve është një dispozitë e re edhe për BE –në e cila është përafëruar në këtë ligj, që i jep mundësi fermerëve të vegjël të certifikohen si grup, duke ulur kostot e certifikimit individual. Rregullat lidhur me përbërjen dhe funksionimin e grupit të operatorëve, parashikohen të miratohen me udhëzim të ministrit (neni 39, pika 6).

**Në kreun gjashtë,** përcaktohen rregullat për kontrollet zyrtare dhe aktivitetet e tjera zyrtare.

Në këtë kre përcaktohen rregullat e veçanta që duhet të zbatohen për kryerjen e kontrolleve zyrtare përveç rregullave të përgjithshme të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për inspektimet dhe kontrollet zyrtare (është në proces miratimi projektligji për kontrollet zyrtare që përafëron rregulloren 625/2017/KE) të ushqimit, ushqimit për kafshë, shëndetit dhe mirëqenien e kafshëve, shëndetit të bimëve dhe produkteve për mbrojtjen e bimëve, për të verifikuar në të gjitha fazat e prodhimit, përgatitjes dhe shpërndarjes, se produktet biologjike janë prodhuar në përputhje me këtë ligj.

Në nenet 41-43, përcaktohen kontrollet zyrtare që kryhen për verifikimin e përputhshmërisë

me këtë ligj dhe veprimet që meren nga autoritetet kompetente, sipas rastit, ministria, AKU ose trupa e kontrollit si dhe dokumentacioni i kontrolleve zyrtare (procesverbal apo raporti me shkrim).

Në nenin 44 përcaktohen detyrimet dhe masat që duhet të merren nga operatorët dhe grupet e operatorëve biologjik, për mbajtjen e të dhënave, deklaratat dhe komunikimet e tjera të nevojshme për kontrollet zyrtare.

Në nenin 45 përcaktohen detyrat që i delegohen nga Ministria, trupave të kontrollit, private për kryerjen e kontrollit zyrtar për verifikimin e plotësimit të rregullave të përcaktuara në këtë ligj, përkatësisht:

- Kryerjen e inspektimit dhe certifikimit, të operatorëve dhe grup operatorëve në sistemin e tyre të kontrollit;
- Miratimin/ lejimin e përjashtimit për përdorimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor jo biologjik në prodhimin biologjik;

Trupat e kontrollit që kryejnë certifikimin e operatorëve biologjik, sipas kërkesave të këtij ligji, duhet të plotësojnë kushtet e përcaktuara në në këtë ligj (neni 45, pika 2) dhe kushte të tjera që parashikohen në pikën 6, të nenit 45.

Në Shqipëri veprojnë edhe trupat e kontrollit që certifikojnë sipas standardeve të tjera për prodhimin biologjik (standarti ekuivalent i BE-së, amerikan NOP, zviceran etj, për qëllim eksporti në këto vende) të cilat deri tani nuk kanë njoftuar/regjistruar aktivitetin e tyre tek autoriteti kompetent (Ministria) sic kërkohet në rregulloren 2021/1698/ KE si kusht për tu njohur nga KE për të vepruar në një vend të tretë.

Në pikën 3, neni 45, përcaktohet që këto trupa duhet të regjistrojnë aktivitetin e tyre duke paraqitur kërkesën në Komisionin për Prodhimin Biologjik që përmban dokumentet (kopje të certifikatës së regjistrimit në regjistrin tregtar të Republikës së Shqipërisë; listën e operatorëve në sistemin e tyre të kontrollit; llojin e aktivitetit dhe kategoritë e produkteve që certifikojnë).

Për miratimin, rinovimin dhe shfuqizimin e miratimit dhe mbikqyerjen e trupave të kontrollit që certifikojnë sipas kërkesave të këtij ligji si dhe regjistrimin ose rregjistrimin e trupave të kontrollit që operojnë sipas standardeve të tjera, në Ministri është ngritur dhe funksionon *Komisioni për Prodhimin Biologjik (KPB)*, i cili është një komision ndërinstitucional. KPB, verifikon dokumentacionin e paraqitur për përmbushjen e kushteve të përcaktuara në këtë ligj dhe aktin nënligjor (neni 46).

Pas miratimit, trupat e kontrollit duhet të mbikqyren/auditohen nëse kryejnë detyrat e deleguara konform legjislacionit. Mbikqyerjen/auditimin e trupave të kontrollit, KPB e kryen nëpërmjet *sektorit për prodhimin organik*, i cili kryen kontrollin fizik dhe raporton në KPB mbi rezultatet e kontrollit të ushtruar dhe në rast se këto trupa nuk operojnë konform kërkesave të këtij ligji i propozon KPB heqjen e miratimit.

Në nenet 48-49, parashikohen masat për pezullimin dhe shfuqizimin e miratimit të trupave të kontrollit, që certifikojnë sipas kërkesave të këtij ligji.

Për trupat e kontrollit që certifikojnë sipas standardeve të tjera për prodhimin biologjik (për eksport) në pikën 3, neni 57, përcaktohet tek kundërvajtjet administrative, ndëshkimi me gjobë në masën 300 000 deri në 500 000 lekë, nëse nuk regjistrojnë aktivitetin e tyre në Ministri.

**Në kreun e shtatë,** përcaktohen rregullat për eksportin dhe importin e produkteve biologjike me vendet e tjera.

Në rregulloren 848/2018/KE, përcaktohen kushtet për importin në BE, pra eksporti ynë, ndërsa për kushtet e vendit tonë, ne duhet të krijojmë një regjim importi duke e përshtatur me atë të BE-së.

Në nenin 54, përcaktohen kushtet për eksportin e produkteve biologjike, nëse plotëson të paktën rregullat e përcaktuara në këtë ligj dhe kushtet e vendit ku eksportohet.

Neni 55, përcakton kushtet e importit të produkteve biologjike dhe në kalim, kur ato konsiderohen ekuivalente ose në përputhje me këtë projektligj, sipas rastit kur importohen nga BE, ose nga vende të treta, përkatësisht kur:

- produkti vjen nga vendet anëtare të BE-së dhe shoqërohet me certifikatën e operatorit e cila konfirmon se produkti është në përputhje me Rregulloren Europiane për prodhimin biologjik,
- produkti vjen nga një vend i tretë, dhe është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Kreun II, III, IV dhe V të këtij ligji dhe të gjithë operatorët dhe grupet e operatorëve, përfshirë eksportuesit në vendin e tretë, *i janë nënshtruar kontrolleve nga trupat e kontrollit ose autoritetet e kontrollit të njohura nga Komisioni Evropian si ekuivalente ose të përputhura (lista në rregulloren 2021/2325/KE) për importin e produkteve biologjike në BE, dhe këto trupa kontrolli kanë pajisur të gjithë këta operatorë, grupe të operatorëve dhe eksportues me një certifikatë ku vërtetohet se ata janë në përputhje me Rregulloren Europiane për prodhimin organik dhe ngarkesa shoqërohet me certifikatën e inspektimit.*
- produkti vjen nga një vend i tretë, i cili është njohur si ekuivalent ose në përputhje, me marrëveshje tregtare me BE, për importin e produkteve biologjike në Bashkimin Evropian, dhe produkti përputhet me rregullat e prodhimit dhe kontrollit të atij vendi të tretë, të cilat janë ekuivalente me këtë ligj, dhe importohet me një certifikatë inspektimi të lëshuar nga autoritetet kompetente, autoritetet e kontrollit ose trupat e kontrollit të vendit të tretë.
- produkti vjen nga një vend i tretë, i cili është i njohur si ekuivalent nga Shqipëria, nëpërmjet një marrëveshje tregtare, që ka një sistem prodhimi biologjik i cili plotëson të njëjtat objektiva dhe parime dhe zbaton rregulla që sigurojnë të njëjtin nivel përputhshmërie me këtë ligj.

Kontrolli i përputhshmërisë me kushtet dhe masat për importin e produkteve biologjike dhe në kalim, kryhet nga AKU dhe autoriteti doganor, në pikat e inspektimit kufitar (neni 56).

Është dakortësuar me Autoritetin doganor (pjesë e grupit të punës) që të shtohet nomenklatura për diferencimin në doganë të produkteve biologjike nga ato jo biologjike, me qëllim që të sigurohet informacioni mbi produktet biologjike të importuara dhe eksportuara. Në ligj përcaktohet që dogana duhet të paraqesë në Ministri, një raport vjetor për produktet biologjike të eksportuara dhe importuara, deri më 31 mars të çdo viti, për vitin paraardhës (neni 56, pika 3).

Rregullat të hollësishme lidhur me kushtet, masat dhe kontrollet e ngarkesave të produkteve biologjike ose në kalim të importuara, do të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, duke përafuar rregulloret implementuese të BE-së (neni 56, pika 4).

Në nenin 45, pika 2, shkronja f, një ndër kushtet për miratim të trupave të kontrollit është zbatimi i katalogut të masave në rastet e mospërputhshmërive të dyshuara ose të vërtetuara, ndaj operatorëve që certifikojnë. Rregullat e hollësishme për hartimin dhe zbatimin e katalogut të përbashkët të masave, miratohen me udhëzim të Ministrit (45, pika 8).

Në zbatim të kërkesave të rregullores 848/2018 përafuar në nenin 51, pika 3, Ministria merr masa administrative dhe sanksionet e nevojshme sipas legjislacionit penal në fuqi për mashtrimin me, për të parandaluar përdorimin e termave që i referohen prodhimit biologjik (termat biologjik/organik/bio) me qëllim mashtrimi.

Në nenin 57, përcaktohen kundravajtjet administrative.

Në kreun e tetë, përcaktohen dispozitat kalimtare dhe të fundit.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT**

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Komisioni për Prodhimin Biologjik, Trupat e Kontrollit, Enti Shtetëror i Farave dhe Fidaneve, Qendra e Transferimit të Teknologjive Fushë Krujë dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Projektligji është hartuar nga grupi ndërinstitucional i punës i miratuar me urdhrin e Ministrit nr. 200, datë 4.5.2022 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e legjislacionit për prodhimin organik”. Në përbërje të grupit të punës, kanë qenë anëtarë nga sektorë të ndryshëm në MBZHR, që mbulojnë çështje specifike që trajtohen në këtë projektligj si dhe përfaqësues nga aktorët që përfshihen në sistemin e kontrollit organik, si AKU, ESHFF, DPA, DPD, MFE, trupat e kontrollit.

Grupi i punës është mbështetur nga 2 ekspertë të projektit BIO.RE.GOAL “Për përmirësimin e kuadrit rregullator dhe institucional për bujqësinë organike në Shqipëri”, financuar nga CEI dhe zbatuar nga CIHAM- Bari, Itali.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Efektet financiare që rrjedhin si rezultat i detyrave që i ngarkon ky ligj autoriteteve përgjegjëse për kontrollin e prodhimit organik, do të përballohen brenda fondeve buxhetore të akorduara për këto autoritete.

**MINISTRI**

**ANILA DENAJ**